REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njesia Org.
Org.Jedinica 02
Org Uni
Nr.Prot:
Broj Prot:
Prot.No: 05-8306
Nr.i faqeve
Br.stranica -7-
No.pages
Data:
Datum:
Date: 29 / 10 / 2025
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zravdstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE/PSO

EMRI I PSO: REAGIMI I MINISTRISË SË SHËNDETËSISË NË RAST TË ALARMIMIT NGA AEROPORTI NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS PËR INCIDENT APO AKSIDENT AJROR

PËRMBAJTJA: PËRSHKRIMI I PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT PËR REAGIM NË RASTE TË INCIDENTEVE DHE AKSIDENTEVE

VERSIONI:[1.0]
DATA E APROVIMIT:[29/10/2025]
AUTOR:[MSh]
NR. I HAPAVE:[VIII]
NR. I NËNHAPAVE:[43]

APROVUAR: Jahë Gecaj

U.D. Sekretar i Përgjithshëm, MSh

V.V

QËLLIMI	PËRSHKRIMI I HAPAVE TË QARTË DHE TË DETAJUAR PËR REAGIMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË (MSH) NË RAST TË NJË INCIDENTI APO AKSIDENTI AJROR TË RAPORTUAR/ ALARMUAR NGA AEROPORTI NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS "ADEM JASHARI", PER KOORDINIM EFEKTIV TË REAGIMIT EMERGJENT SHËNDETËSOR DHE MBROJTJES SË JETËS SË QYTETARËVE. KJO PSO ZBATOHET NGA TË GJITHA NJESITË VARTESE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE TE GJITHA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE NË NIVEL VENDI.
NDËRLIDHJA ME AKTET	• LIGJI NR.04/L-125 PËR SHËNDETËSI • LIGJI NR. 02/L-78 LIGJI PËR SHËNDETËSI PUBLIKE • LIGJI NR.08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE; • PLANI I REAGIMIT KOMBËTAR/2010/ FME 8 SHËRBIMET MJEKËSORE DHE SHËNDETI PUBLIK; • PËRDITËSIMI I PLANI I REAGIMIT KOMBËTAR/ 2023; • LIGJI NR. 03/L-051 I REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR AVIACIONIN CIVIL; • RREGULLORES NR. 17/2017 PËR DISPOZITAT DHE PROCEDURAT ADMINISTRATIVE NË LIDHJE ME AERODROMET; • RREGULLORE EU 139/2014; • LIGJI NR. 03/L-051 I REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR AVIACIONIN CIVIL; • ICAO ANEKSI 12 – KERKIM SHPETIM; • ICAO ANEKSI 14 – VËLLIMI 1; • ICAO DORACAKU I SHËRBIMEVE, PJESA 7, PLANIFIKIMI EMERGJENT I AEROPORTIT; • PLANI EMERGJENT I AEROPORTIT (SIPAS PERDITESIMIT); • RRNSH (RREGULLORJA NDËRKOMBËTARE E SHËNDETIT); • LIGJI NR. 06/ L-122 PER MINISTRINE E MBROJTJES; • LIGJI NR. O8/L-158 PER NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/ L-122 PËR MINISTRINË E MBROJTJES; • LIGJI NR.06/ L-042 PER GJAK DHE PËRBËRËS TË GJAKUT; • LIGJI NR. 2003/22 PER INSPEKTORATIN SANITAR TË KOSOVËS; • LIGJI NR. 06/L-114 PËR SHËRBIMIN EMERGJENT MJEKËSOR; • SISTEMI I INTEGRUAR I MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE, MAJ, 2010
LISTA E SHKURTESAVE	AME AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E EMËRGJENCAVE ANP AEROPORTI NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS DAIS DEPARTAMENTI I SHËRBIMIT TË INFORMACIONIT AERONAUTIK DKPSH DIVIZIONI I KUJDESIT PARËSOR SHËNDETËSOR IKSHPK INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS KANS/ ASHNA SHËRBIMI I NAVIGIMIT AJROR TË KOSOVËS KVN KOMANDA E VËNDIT TË NGJARJES MIQ MJEKIMI INTENSIV QENDROR MSH MINISTRIA E SHËNDETËSISË P PRIORITETI PRK PLANI REAGIMIT KOMBËTAR QKKTGJ GJAKUT QENDRA KOMBËTARE E KOSOVËS PËR TRANSFUZION TË QKMF QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE QKUK QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS QMU QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE QOE QENDRA OPERATIVE EMERGJENTE RVP PIKË TAKIM (RENDEZVOUS POINT) SIME SISTEMI I INTEGRUAR I MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE SKI SISTEMI I KOMANDËS SË INCIDENTIT SO SALLAT OPERATIVE

PROCEDURA

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Pranimi i informatës dhe alarmimi	1. Alarmi fillestar për incidentin/aksidentin inicohet nga Kulla Trafikut Ajror/ KANS, e cila informon Departamentin e Shërbimit të informacionit Aeronautik (DAIS); 1.1. DAIS-i alarmon: - Qendrën emergjente e thirrjeve 112; - QMU Prishtinë; - Zyrtarin për shërbime emergjente dhe urgjente në MSh; - Qendra emergjente e thirrjeve 112- njofton QKMF në Lipjan, Fushë Kosovë dhe Drenas;
[II]	Reagimi i Ministrisë së Shëndetësisë pas pranimit të informatës për incidentin/ aksidentin	Pas marrjes së njoftimit fillestar nga Departamenti Aeronautik i Shërbimit të Informacionit (DAIS) për ndonjë incident apo aksident ajror, Ministria e Shëndetësisë: 1. Aktivizon dhe udhëheq reagimin emergjent shëndetësor në nivel vendi, sipas parimeve të Sistemit të Komandës së Incidentit (SKI) bazuar në dokumentin "Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave (SIME 2010, AME)" dhe PRK; 2. Sipas nevojës dhe nivelit të alarmit, aktivizon strukturat dhe Institucionet shëndetësore relevante në nivel vendi; 3. Siguron koordinimin e kujdesit shëndetësor efektiv të të lënduarve; 4. Bashkëpunon ngushtë me të gjithë Institucionet relevante të cilat janë pjesë e QOE/ANP; 5. Siguron mbështetje logjistike, burime njerëzore dhe furnizime mjekësore.
[III]	Reagimi i zyrtarit për shërbime urgjente dhe emergjente në MSh	1. Zyrtari përgjegjës për shërbime emergjente dhe urgjente në MSh pranon informatën përmes telefonit për nivelin e alarmimit të aktivizuar; 2. Në rast të aktivizimit të alarmit 2, pas pranimit të informatës, zyrtari për shërbime urgjente dhe emergjente në MSh qëndron në gjendje gatishmërie; 3. Në rast të alarmimit të nivelit 2, zyrtari për shërbime urgjente dhe emergjente në MSh, kontakton Udhëheqësin e Divizionit të Kujdesit Parësor Shëndetësor për t'u njoftuar se ekipet mjekësore më të afërta të QKMF-ve në zonën e

		përgjegjësisë a janë aktivizuar apo janë në gjendje gatishmërie; 4. Udhëheqësi i DKPSh-se kontakton institucionet e KPSh dhe njëkohësisht konfirmon se a janë njoftuar këto institucione nga 112; 5. Udhëheqësi i DKPSh-se njofton zyrtarin për emergjenca në MSh për nivelin e gatishmërisë së QKMF-ve përkatëse dhe vërteton se a kanë marr apo jo informatën nga 112; 6. Zyrtari për shërbime emergjente dhe urgjente në MSh, sigurohet që ekipet mjekësore janë të gatshme dhe janë nisur në drejtim të Aeroportit (alarm 2, 3) për në pikë takimin e mjeteve emergjente pikë takim (RVP-Rendevous Point); 7. Zyrtari për shërbime emergjente dhe urgjente në MSh pas pranimit të alarmit të nivelit 3, obligohet të paraqitet fizikisht në QOE/ANP; 8. Zyrtari për shërbime emergjente dhe urgjente në MSh nga QOE/ANP i raporton Ministrit të shëndetësisë dhe kërkon në MSh për zbatimin e kërkesave të pranuara (si p.sh. resurse shtesë njerëzore, pajisje mjekësore dhe logjistike); 9. Zyrtari për shërbime emergjente dhe urgjente në MSh, sigurohet që ekipet mjekësore janë të gatshme/gjendje gatishmërie me mundësinë për reagim në aeroport (alarm 4 ose 5).
[IV]	Reagimi i Koordinatorit Mjekësor për Emergjenca nga MSh	1. Koordinatori mjekësor për emergjenca emërohet nga Ministria e Shëndetësisë; 2. Koordinatori udhëheqë dhe merr pjesë aktive në triazhim dhe bashkëpunon me ekipet mjekësore për pacientët në kategori sipas triazhit -prioriteteve (kuqe P1, verdhë P2, gjelbër P3, zi); 3. Koordinatori mjekësor për emergjenca nga MSh, raporton për çdo 10 pacientë të trajtuar në QOE/ANP për rastet e të lënduarve në masë; 4. Në bazë të situatës që zhvillohet, koordinatori mjekësor për emergjenca nga MSh, informon komandën në vendin e ngjarjes rreth nevojave dhe kërkesave për mobilizim të resurseve shtesë për menaxhimin e situatës në aspektin shëndetësor nga KVN/ QOE/ANP; 5. Raporton për numrin e pacientëve dhe gjendjen e tyre shëndetësore sipas nevojës dhe kërkesës;

		6. Në rastet emergjente apo incidentet/aksidentet me aeroplan ushtarak koordinatori mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë do të jetë në koordinim me koordinatorin mjekësor nga KFOR-i; (KFOR pranon strukturën komanduese sipas planit Emergjent dhe bazuar në këtë, vetëm në sektorin mjekësor dhe të sigurimit e dërgon koordinatorin).
[V]	Reagimi i Institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor	1. Mobilizohen/aktivizohen ekipet mjekësore nga Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor fillimisht me të afërta me ANP (QKMF Lipjan, Fushe Kosove, Drenas dhe Qendra Urgjente- Prishtine) pastaj varësisht nga numri i të lënduarve në masë mobilizohen edhe ekipet mjekësore nga QKMF-të tjera; 2. Bëjnë triazhimin e të lënduarve; 3. Trajtimin dhe menaxhimin e gjendjes shëndetësore të të lënduarve në vendin e ngjarjes (intervenimet bazike); 4. Bashkëpunojnë me akterët tjerë relevant reagues në vendin e ngjarjes; 5. Referimin e të lënduarve sipas nevojës në Emergjencën e QKUK-së apo ne Emergjencën e Spitaleve të Përgjithshme.
[VI]	Reagimi i ShSKUK-së (Spitalet e Përgjithshme me Klinikat e QKUK-së)	**Spitalet e Përgjithshme:** 1. Aktivizojnë zonën e jashtme të triazhit dhe bëjnë klasifikimin e pacientëve sipas emergjencës për shërbime elektive ose jo; 2. Mobilizojnë sallat e operacionit dhe laboratorët 24/7; 3. Marrin rastet urgjente, por të menaxhueshme konfrom patologjive dhe kapaciteteve përkatëse; 4. Transferojnë rastet kritike drejt Klinikave të QKUK-së; **Klinikat e QKUK-se:** 5. Pranojnë rastet më komplekse: neurokirurgji, djegie masive, trauma torakale/multi trauma etj.; 6. Sigurojnë kapacitete shtesë të njësive intensive; 7. Sigurojnë ekipe multidisiplinare kirurgjike;

		8. Japin mbështetje logjistike për spitalet e përgjithshme në bazë të kërkesave.
[VII]	Reagimi i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK)	1. Mbikëqyrjen epidemiologjike – monitoron dhe vlerëson rrezikun për përhapje të sëmundjeve ngjitëse nëse ka pasagjerë nga zona me epidemi ose incidente me substanca biologjike; 2. Ekspertizën teknike – ofron këshilla shkencore dhe udhëzime për menaxhimin e rasteve me rrezik biologjik dhe/apo kimik; 3. Analizat laboratorike – nëse ka dyshime për ekspozim ndaj agjentëve të rrezikshëm (viruse etj.), merr mostra dhe kryen analiza për konfirmim; 4. Sigurinë e ujit, ushqimit dhe mjedisit –verifikon kushtet higjiene-sanitare në rast se incidenti ndikon në furnizim me ujë, ushqim ose ndotje të ajrit; 5. Përpilon raporte të shpejta dhe materiale informuese për MSh – përpilon raporte të shpejta dhe materiale informuese për rrjetet sociale, mbi ndikimin e aksidentit/incidentit në shëndetin publik, propozon rekomandime dhe masa parandaluese adekuate.
[VIII]	Reagimi i Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzion të Gjakut (QKKTGj)	1. Mobilizon rezervat e gjakut dhe të plazmës duke shpërndarë menjëherë dozat e gjakut sipas nevojave urgjente; 2. Siguron furnizimin e vazhdueshëm të gjakut dhe produkteve të gjakut; 3. Kontrollon cilësinë dhe sigurinë që çdo njësi gjaku të jetë testuar (për HIV, HBsAg, HCV dhe sifilis) për të shmangur rreziqe shtesë gjatë emergjencave; 4. Koordinohet me Spitalet e përgjithshme dhe me QKUK-në dhe komunikon me MSh-në.

Shtojcë 1: Afatet kohore të Reagimit nga Institucionet shëndetësore gjatë Alarmit 3 dhe 4

Koha	Kujdesi Parësor	Shërbimet emergjente/ Autoambulancat e QKMF-ve dhe QMU	Spitale Përgjithshme	QKUK
0–15 min	Alarmim	Nisja në terren	Aktivizim plani	Aktivizimi i Ekipeve MD
15–30 min	Stabilizim bazë	Triazh në terren	Hapje triazhimit të jashtëm	Përgatitje MIQ/SO
30–60 min	Transferime	Transport i parë	Pranimi i të lënduarve	Rastet kritike
1–2 orë	Monitorim	Transport i vazhdueshëm	Operacione	Kirurgji komplekse
>2 orë	Vazhdim stabilizimi	Pastrim terreni	Kujdes afatmesëm	Rehabilitim